



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/13
Datë: 26.05.2021


Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë, 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në përputhje me nenin 71, paragrafi 3 dhe nenin 33 të Rregullores nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të adresimit të prioritetit nacional për sigurimin e vaksinave kundër COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26.05.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria ka shqyrtuar dhe analizuar draftin përfundimtar të Marrëveshjes për Prodhim dhe Furnizim ("**Marrëveshja**"), që do të nënshkruhet nga:
 - (i) Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës ("**Ministria**"), duke vepruar në emër të saj dhe në emër të Republikës së Kosovës; dhe
 - (ii) Pfizer Export B.V me zyra në Rivium Westlaan 142, 2909LD Capelle aan den IJssel, Holandë.
2. Qeveria miraton Marrëveshjen dhe autorizon Ministrin e Shëndetësisë që të nënshkruaj Marrëveshjen dhe të detyrojë Republikën e Kosovës për secilën nga dispozitat, termat dhe kushtet e Marrëveshjes.
3. Qeveria konfirmon që Marrëveshja është konform përjashtimit të parashikuar nga neni 3, paragrafi 3.4 i Ligjit Nr. 04 / L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (me ndryshimet).

4. Për shkak të marrëveshjes së konfidencialitetit në mes të palëve, marrëveshja nuk do të publikohet në asnjë website të institucioneve apo në Gazetën Zyrtare.
5. Për shkak të marrëveshjes së konfidencialitetit në mes të palëve, vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa publikohet në Gazetën Zyrtare pas nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e të dyja palëve.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës